



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr 5, Date 26/01/2001

**PER
SHTESE NE FONDIN E PAGAVE PER 6 PUNONJES TE BASHKISE PER
DEKORIN DHE SIMBOLET**

Këshilli Bashkiak u njoh me relacionin e paraqitur për shtesë në fondin e pagave për gjashtë punëtor provizior për dekorin dhe simbolet dhe mbështetur në ligjin Nr.7776 “Për buxhetin lokal” dhe ligjin Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”

V E N D O S I

Të miratojë fondin prej 190.000 lekë për pagën e tre muajve të fundit të vitit 2000, për gjashtë punonjës të dekorit dhe simboleve në Bashkinë e Tiranës. Fondi merret nga të ardhurat e Bashkisë për kulturën dhe likujdohet nga zyra e llogarisë në Bashki.

1. Zbatimin e vendimit e ndjek Drejtoria e Financës
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA

